

# **Indeksi i Çmimeve të Prodhimit**

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)

**INSTAT**

## Metadata Referenciale

1. [Kontakt](#)
2. [Përditësimi i metadatave](#)
3. [Paraqitja statistikore](#)
4. [Njësia matëse](#)
5. [Periudha e referencës](#)
6. [Mandati institucional](#)
7. [Konfidencialiteti](#)
8. [Politika e botimit](#)
9. [Shpeshësia e shpërndarjes](#)
10. [Aksesi në të dhëna dhe qartësia](#)
11. [Manaxhimi i cilësisë](#)
12. [Rëndësia](#)
13. [Saktësia dhe besueshmëria](#)
14. [Afatet kohore dhe përpikmëria](#)
15. [Koherenca dhe Krahasueshmëria](#)
16. [Kostoja dhe ngarkesa](#)
17. [Rishikimi i të dhënave](#)
18. [Përpunimi statistikor](#)
19. [Komente](#)

[Aneks](#)

| <b>1. Kontakt</b>                      |   |
|--|---|
| 1.1. Institucioni i kontaktit          | INSTAT, Instituti i Statistikave  |
| 1.2. Njësia e kontaktit                | Sektori i Çmimeve   |
| 1.3. Personi i kontaktit               | Jesmina Mustafaj  |
| 1.4. Funkzioni i personit të kontaktit | Specialiste në Sektorin e Çmimeve   |
| 1.5. Adresa postare                    | Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri, Kodi Postar 1017  |
| 1.6. Adresa elektronike (e-mail)       | <a href="mailto:jmustafaj@instat.gov.al">jmustafaj@instat.gov.al</a>  |
| 1.7. Numri i telefonit                 | +(355) 4 233356 / 233/ 240  |
| 1.8. Numri i faksit                    | +(355) 4 228300   |
| <b>2. Përditësimi i metadatave</b>     |   |
| 2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës  | 06.03.2020  |
| 2.2. Publikimi i fundit i metadatës    | 05.03.2019  |
| 2.3. Përditësimi i fundit i metadatës  | 06.03.2020  |
| <b>3. Paraqitja statistikore</b>       |   |
| 3.1. Përshkrimi i të dhënave           | <p>Indeksi i Çmimeve të Prodhimit mat ecurinë e çmimeve të prodhimit të produkteve industriale të prodhuara me destiancion tregun vendas dhe eksport. Ky indeks përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Indeksi Gjithsej i Çmimeve të Prodhimit;</li> <li>· Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në Industri për tregun vendas, i cili mat ecurinë e çmimeve të prodhimit të produkteve industriale të prodhuara dhe shitur në tregun vendas;</li> </ul> |

|  |  |
|--|--|
|  | <p>· Indeksi i Çmimeve të Eksportit, i cili mat ecurinë e çmimeve (të konvertuara në monedhën vendase përfshirë kursin e këmbimit) të produkteve industriale të prodhuara në vend dhe me destinacion shitjeje tregun e huaj.</p>   |
| 3.2. Sistemi i klasifikimit                | <p>Klasifikimi i përdorur për Indeksin e Çmimeve të Prodhimit është Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2). Të dhënat prodhohen në nivel kombëtar, të grupuar në nivel dy shifror sipas aktivitetit ekonomik të kësaj nomenklature. Deri në tremujorin e dytë 2014, të dhënat janë prodhuar duke përdorur NVE Rev.1.1. Duke filluar nga tremujori i dytë 2014, të dhënat publikohen në NVE Rev.2.</p>   |
| 3.3. Mbulimi i sektorit                    | <p>Mbledhja e të dhënave bëhet sipas rregullores 1165/98, e cila është miratuar në vitin 1998 dhe është ndryshuar në vitin 2005 në rregulloren 1185/2005 1999 – 2014, Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE) Rev.1.1, Klasifikimi i Produkteve sipas Aktivitetit Ekonomik (KP), 1996 – 2002. · Industri nxjerrëse – C: 10 – 14 · Industri përpunuese – D: 15 – 36 · Energji elektrike, ujë dhe gaz - D: 40 – 41 2015 e në vazhdim NVE Rev.2, KP 2008 · Industri nxjerrëse – B: 05 – 09 · Industri përpunuese – C: 10 – 34 · Energji elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar – D: 35 · Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, E: 36- 38.</p>   |
| 3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime | <p>Indeksi i Çmimeve të Prodhimit mat ndryshimin e çmimeve të prodhimit të produkteve që prodhohen në Shqipëri dhe që shiten nga prodhuesit në tregun e brendshëm (shqiptar) dhe/ose në tregun e jashtëm. Çmimi është e ardhura neto që fiton ndërmarrja prodhuese nga blerësi i një produkti të transportuar nën termat e caktuara të shitjes. Çmimi relativ është indeksi më i thjeshtë i ndryshimit të çmimit në përqindje të një produkti në dy periudha kohe të dhënë ku njëra prej tyre përbën periudhën bazë. Pësha e produktit përcaktohet nga të dhënat mbi vlerën e shitjes së produktit. Kjo vlerë përfshihet në pyetsorë (1 herë në vit) dhe merret nga intervista e drejtpërdrejtë me ndërmarrjen. Për llogaritjen e peshave përdoren të dhënat e Shitjeve neto nga Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike joBujqësore. Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korrente në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet nga efektet e papërsëritshme të cilitdo tremujor. Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit midis dy tremujorëve më të fundit. Megjithëse korrent, ai mund të ndikohet nga efekte sezonale dhe efekte të tjera.</p> |

|  |   |
|--|---|
| 3.5. Njësia statistikore                   | Njësia statistikore për llogaritjen e Çmimeve të Prodhimit është ndërmarrja e prodhimit me aktivitet kryesor të përfshirë në fushën e mbulimit të indeksit sipas NVE Rev.2.   |
| 3.6. Popullata statistikore                | Të gjithë ndërmarrjet aktive në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Seksionet: B, C, D, E sipas NVE Rev.2.  |
| 3.7. Zona e referencës                     | Të dhënat e IÇP përfshijnë të gjithë territorin e vendit.   |
| 3.8. Mbulimi në kohë                       | Seritë kohore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit: 1999 – 2005 sipas NVE Rev 1.1. · Seri Kohore 2005-2014, NVE Rev.1 dhe NVE Rev.2. (2005=100, 2010=100) · Indekset e Çmimeve të Prodhimit për Tregun Vendas dhe Eksport: 2007 e në vazhdim.  |
| 3.9. Periudha bazë                         | Periudha bazë për IÇP është viti 2010.  |
| <b>4. Njësia matëse</b>                    | Njësitë matëse janë:<br>· Indekset<br>· Ndryshim tremujor në përqindje<br>· Ndryshim vjetor në përqindje.   |
| <b>5. Periudha e referencës</b>            | Frekuencë tremujore me periudhë reference mujore. Ky raport i përket vitit referencë 2019.  |
| <b>6. Mandati institucional</b>            |   |
| 6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera | Baza ligjore: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a> ;</li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2017-2021</a>;</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Këshilit Evropian Nr.1165/98</a>, “Mbi treguesit Afatshkurtër”;</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1503/2006</a> për Statistikat Afatshkurtra;</li> <li>• Manuali i Statistikave Afatshkurtra: Manuali për prodhimin e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit: Teoria dhe praktika 2004.</li> </ul> |
| 6.2. Shkëmbimi i të dhënave                | Statistikat e IÇP transmetohen në EUROSTAT. Aktualisht INSTAT   |

|   |   |
|---|---|
|   | <p>plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me rezultatet e vrojtimit të çmimeve të prodhimit, si Komisioni Europian, Enterprise and Industry Directorate-General, OECD, etj.</p>   |
| <p><b>7. Konfidencialiteti</b></p>                        |   |
| <p>7.1. Konfidencialiteti<br/>- politika</p>              | <p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit “Për statistikat zyrtare” përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>   |
| <p>7.2. Konfidencialiteti<br/>- trajtimi i të dhënave</p> | <p>Instituti i Statistikave të Shqipërisë mbron dhe nuk shpërndan të dhënat e grumbulluara ose tek të cilat ka akses, që mundësojnë identifikimin direkt ose indirekt të njësive statistikore. Instituti i Statistikave merr të gjitha masat parandaluese në mënyrë që të bëjë të pamundur identifikimin e njësive të veçanta statistikore me mjete teknike ose mjete të tjera, që në mënyrë të arsyeshme mund të përdoren nga një palë e tretë. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore shpërndahen nga Instituti i Statistikave nëse dhe vetëm nëse: a) këto të dhëna janë trajtuar, ashtu siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, në mënyrë të tillë që shpërndarja e tyre nuk paragjykon konfidencialitetin statistikor ose b) njësia statistikore ka dhënë pëlqimin e saj, pa asnjë rezervë, për zbulimin e të dhënave. Të dhënat konfidenciale që i transmetohen Institutit të Statistikave përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe personat e vetëm që kanë të drejtë të kenë akses në këto të dhëna janë personeli i angazhuar në këtë detyrë. Çështjet që i referohen respektimit e konfidencialitetit statistikor shqyrtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Është përgjegjësi e këtij stafi të sigurojë sa mëposhtë: Nivelin e detajimit në të cilën të dhënat statistikore mund të shpërndahen, në mënyrë që identifikimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i njësisë statistikore të anketuar nuk është i mundur; kriterin e anonimatit për të dhënat në nivel mikro të ofruara për përdoruesit; dhënia akses tek të dhënat konfidenciale për studiuesit për qëllime shkencore.</p> |

| <b>8. Politika e botimit</b>              |  |
|---|--|
| 8.1. Kalendar i publikimeve               | Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.  |
| 8.2. Akses në kalendarin e publikimeve    | <a href="#">Kalendar</a> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.  |
| 8.3. Akses i përdoruesve                  | Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:<br><ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Publikimi;</li> <li>4. <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol> |
| <b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>       |  |
|   | Shpeshësia e shpërndarjes të të dhënave të IÇP është çdo tremujor.   |
| <b>10. Akses në të dhëna dhe qartësia</b> |  |
| 10.1. Njoftim për media                   | Sipas Kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Indeks të Prodhimit të Prodhimit. Format i njoftimit për shtyp është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i IÇP publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.  |
| 10.2. Publikime                           | Të gjitha të dhënat për IÇP, përdoruesit mund ti gjejnë në faqen e internetit të INSTAT. <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Shifrat</a></li> <li>• <a href="#">Publikimi i dedikuar IÇP</a></li> </ul>   |

|                                   |  |
|-----------------------------------|--|
| 10.3. Baza e të dhënave on-line   | Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: <a href="#">Databaza</a> .  |
| 10.4. Aksesimi në të dhënat mikro | Të dhënat e IÇP nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare".   |
| 10.5. Të tjera                    | Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linkun më poshtë: <a href="#">Kërkesë të dhënash</a> .  |
| 10.6. Dokumentimi i metodologjisë | Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">metodologjinë</a> mbi vërtetimin e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit.  |
| 10.7. Dokumentimi i cilësisë      | Sektori i Çmimeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit për qëllime të brendshme.  |
| <b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>   |  |
| 11.1. Sigurimi i cilësisë         | INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin "Për statistikat zyrtare", Nr.17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Kontrollat e |

|                               |  |
|-------------------------------|--|
|                               | <p>cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlogaritjen e indeksit dhe është i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare.</p>  |
| 11.2. Vlerësimi i cilësisë    | <p>Sektori kontrollon çmimet e çdo muaji. Nëse vërehet ndonjë çmim që ka lëvizje të madhe krahasuar me muajin e mëparshëm komunikohet me anketuesin. Nëse marrim një shpjegim justifikues për këtë ndryshim, çmimi përfshihet në llogaritje. Përndryshe anketuesi duhet të verifikojë përsëri çmimin e mbledhur në terren.</p>   |
| <b>12. Rëndësia</b>           |  |
| 12.1. Nevojat e përdoruesit   | <p>Përdoruesit e IÇP-së ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione të administratës publike;</li> <li>• Universitetet;</li> <li>• Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare;</li> <li>• Bizneset;</li> <li>• Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme</li> </ul> <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e IÇP- së si input në punën e tyre. Këto janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare;</li> <li>• Sektori i Statistikave Afatshkurtra.</li> </ul> |
| 12.2. Kënaqësia e përdoruesit | <p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Indeksit të Çmimeve të Prodhimit për vitin 2019 janë rreth 2, 905 klikime.</p> <p>Gjatë 2019 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme të statistikave të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është vlerësuar me 3.66 (ose 73.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>  |
| 12.3. Plotshmëria             | <p>Statistikat e IÇP janë ndërtuar në përputhshmëri me rregulloren e Eurostatit në numër variablash, niveli i plotshmërisë të treguesve të prodhuar është 100 %. Kjo përlogaritje ka marrë në konsideratë rregulloren evropiane në nivel variablash.</p>   |



| <b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>     |  |
|--|--|
| 13.1. Saktësia e përgjithshme            | Saktësia e përgjithshme e të dhënave të IÇP konsiderohet të jetë e lartë veçanërisht në saktësinë metodologjike të burimit të peshave dhe çmimeve dhe llogaritjes në përputhje me Rregulloren Evropiane.   |
| 13.2. Gabim i kampionimit                | Nuk është e aplikueshme për aktivitetin statistikor, pasi të dhënat e IÇP janë të bazuara në kampione jo-probabilitare.  |
| 13.3. Gabim jo i kampionimit             | Gabimet jo të kampionimit janë kryesisht gabime që ndodhin gjatë matjeve ose refuzimeve. Këto gabime vlerësohen dhe krahasohen me rezultatet e periudhave të mëparshme. Për të marrë informacionin korrekt dhe për të rritur normën e përgjigjeve, ndërmarrjet rikontaktohen me telefon ose drejtpërdrejt. Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mospërgjigjes në nivel rekordi për IÇP 2019 është 5.6%. |
| <b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b> |  |
| 14.1. Afatet kohore                      | Rezultatet e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 65 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 65 ditë).   |
| 14.2. Përpikmëria                        | Të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i IÇP ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.   |
| <b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b> |  |
| 15.1. Krahasueshmëria gjeografike        | Çmimet e prodhimit grumbullohen në nivel vendi. Indekset llogariten në nivel vendi duke përdorur definicionet sipas rregulloreve evropiane.  |
| 15.2. Krahasueshmëria kohore             | Statistikat e IÇP sigurohen me frekuencë tremujore dhe vjetore dhe janë të krahasueshme. Seria kohore për IÇP ekziston nga viti referencë 1999. (Periudha bazë ka ndryshuar: 1999 = 100, 2005 = 100 dhe aktualisht 2010 = 100).  |

|  |  |
|--|--|
| 15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave       | Indekset janë pjesërisht të krahasueshme me Indeksën e Çmimeve të Konsumit dhe treguesit statistikorë të tregtisë së jashtme.  |
| 15.4. Koherenca e brendshme                    | Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.  |
| <b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>                | <p>Personat që punojnë për anketat e Çmimeve: IKN, IÇP, IÇI dhe IÇSh: Gjithsej: 73 punonjës</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Staf i përgjithshëm në zyrat qendrore: 3 punonjës</li> <li>· Intervistuesit 65 nga të cilët: 40 anketues afatgjatë dhe 25 afatshkurtër</li> <li>· Operatorët (4 muaj): 5 punonjës.</li> </ul>   |
| <b>17. Rishikimi i të dhënave</b>              |  |
| 17.1. Politika e rishikimit                    | <p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. E njëjta politikë rishikimi zbatohet për të dhënat në nivel kombëtar dhe ato të transmetuara në Eurostat. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve.</a></li> </ul> |
| 17.2. Praktika e rishikimit                    | Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare dhe mund të rishikohen. Indekset mund të rishikohen për disa arsye: informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë, korrigjime të gabimeve ose ndryshime metodologjike, por rishikimet janë përgjithësisht mjaft të kufizuara në shkallë.   |
| <b>18. Përpunimi statistikor</b>               |  |
| 18.1. Burimi i të dhënave                      | <p>Burimi i të dhënave për IÇP janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Anketa Strukturore pranë ndërmarrjeve ekonomike jobujqësore;</li> <li>· Anketa tremujore e çmimeve të prodhimit;</li> <li>· Të dhënat nga dogana.</li> </ul>   |
| 18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave | Frekuencë 3 mujore me informacion mujor.   |
| 18.3. Grumbullimi i të dhënave                 | Grumbullimi i të dhënave realizohet nëpërmjet Anketës së Çmimeve të  |

|                                       |  |
|---------------------------------------|--|
|                                       | <p>Prodhimit. Mbledhja e rregullt e të dhënave të çmimeve normalisht rrjedh nga një kampion i njërive statistikore. Plotësimi i informacionit realizohet me intervistim të drejtpërdrejt nga ana e anketuesit me personin e kontaktit të ndërmarrjes, i cili është ngarkuar për të deklaruar të dhënat.</p>  |
| <p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p> | <p>Verifikimi i çmimeve: çmimet e mbledhura krahasohen me trendin e tyre historik, ndryshimet e çmimeve për produkte të ngjashme dhe njohuri të tjera të fituara nga analistët; ndryshimet e konsiderueshme të çmimeve verifikohen me njësinë raportuese. Në INSTAT, çmimet kontrollohen në pyetësor, gjatë procesit të hedhjes së të dhënave dhe me telefon në rastet kur pyetësi nuk është plotësuar si duhet.</p>   |
| <p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>   | <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga intervistuesit. Qëllimi është sjellja e këtij informacioni në nivel statistikor. Ky proces vijon si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli fizik i pyetësorëve</li> <li>• Kontrolli logjik i pyetësorëve (kontrollin e indikatorëve, përshkrimin dhe kodifikimin e aktivitetit, dhe kontrollin e vlerave të sakta.)</li> <li>• Procesi i editimit të të dhënave të mbledhura (gabimet dhe modifikimet)</li> <li>• Njësitë që refuzojnë dhe informacioni që mungon duhet të plotësohet përmes procesit të imputimit.</li> </ul> <p>Analiza e rezultateve sipas çdo domeni të publikimit.</p>   |
| <p>18.6. Rregullimi</p>               | <p>Mungesa e çmimeve: Në rastet e mungesës së çmimit të një produkti për imputim përdoret çmimi i muajit të mëparshëm. Zëvendësimi i produkteve që ndërmarrja nuk i prodhon më: Nëse produkti bëhet i padisponueshëm, kryhet zëvendësimi i tij me një produkt, i cili ka karakteristika të ngjashme me të dhe bën pjesë në të njëjtin grup 6 - shifror sipas NP. Zëvendësimi realizohet në bashkëpunim me njësinë statistikore. Për produktin zëvendësues merret informacion për çmimin në periudhën e mëparshme. Rregullimet e cilësisë aplikohen kur vërehen diferenca të çmimit si pasojë e ndryshimit të cilësisë së produktit. Nga njësia statistikore kërkohet një vlerësim i ndryshimit në cilësinë e produktit. Ky informacion përdoret për aplikimin e metodave të rregullimit cilësor. Produktet e reja: Produktet e reja përfshihen në fund të vitit dhe janë pjesë e kampionit për periudhën pasardhëse. Produktet sezonale: Çmimi i fundit i vrojtuar për produktin sezonal përdoret për llogaritjen e indeksit deri në momentin kur produkti rishfaqet në treg. Të dhënat nuk janë të përshtatura sezonalisht.</p> |

|                    |  |
|--------------------|--|
| <b>19. Komente</b> |  |
| <b>Aneks</b>       |  |
|                    |  |